

Rektorati është organi kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:

- Rektori;
- Zëvendësrektorët;
- Administratori i UK-së;
- Dekanët e njësive kryesore.

Në mbledhjen e rektoratit, sipas nevojës, mund të ftohen edhe funksionarë të tjerë të Universitetit dhe/apo të njësive të tjera.

Funksionet e Rektoratit janë:

- Harton planin strategjik të zhvillimit të UK-së, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore të universitetit, si dhe ato të administratorëve.
- Mbi bazën e propozimeve të ardhura ndërmerr nismën për hapjen, mbylljen apo riorganizimin e njësive kryesore dhe njësive të tjera të veçanta në nivel universiteti.
- Jep mendim për tematika dhe probleme, të cilat prekin funksionimin dhe autonominë e UK-së.
- Formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore.
- Përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projektbuxheti vjetor.
- Paraqet rekomandime në Senat mbi strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet.
- Harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik.
- Harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, brenda muajit janar të vitit pasardhës.
- Harton planin për bashkëpunimet dhe marrëveshjet që janë kompetencë e tij dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik.
- I paraqet Senatit Akademik dhe/ose Bordit të Administrimit rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë.
- Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
- Monitoron veprimtarinë e UK-së dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij.
- Përgatit dhe miraton rregulloren e tij të punës.
- Propozon në Senat Kodin e Etikës.
- Trajton dhe vendos për ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve.
- Vë në dispozicion infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e veprimtarisë së universitetit dhe organeve të tij.
- Realizon kontrole periodike në njësitë e universitetit për përmbushjen e objektivave të parapara, si dhe për zbatimin e akteve dhe legjisllacionit në fuqi.

Marrëdhëniet e Rektoratit me organet e tjera të universitetit, si dhe detyrat e tjera përcaktohen në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.

Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori ose të paktën një e treta e anëtarëve të rektoratit. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal. Rektorati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.

Rektorati harton rregulloren e funksionimit të tij e cila miratohet nga Senati Akademik.